

URDHËR
Nr. 687, datë 29.12.2025

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR NDJEKJEN E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT “MJEDIS I PASTËR DHE ME AFTËSI RIPËRTËRITËSE, DETI BLU”
IBRD AL-95070**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 5/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, për projektin “Mjedis i pastër me aftësi ripërtëritëse, deti blu” sipas huas me numër AL-95070, si dhe në mbështetje të udhëzimeve të Manualit të Procedurave Operacionale të Bankës Botërore për zbatimin e projektit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, znj. Ledina Beqiraj Agalliu, në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm pranë Ministrisë së Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit të përcaktuara në projektin “Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse, deti blu”, sipas huas me numër AL-95070, në përputhje me Manualin e Procedurave Operacionale, si dhe për çdo detyrë tjetër të përcaktuar nga ministri i Mjedisit në kuadër të këtij projekti.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj